

KONTRATE E THEMELIMIT
TE SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"TOBACCO HOLLDINGS GROUP" SHPK



Neni 1

Ne ortaket:

1. Lirim Fezollari, i biri i Feridonit i datelindjes 1972, banues ne Tirane, rruga "Sami Frasheri", pall.20, shk.1, ap.8.
2. Kosta Jankovski i biri i i datelindjes 1960, lindur ne Maqedoni, banues ne Tirane, rruga "Sami Frasheri", pall.20, shk.1, ap.8.
3. Zoran Jankovski i biri i i datelindjes 1966, lindur ne Maqedoni, banues ne Tirane, rruga "Sami Frasheri", pall.20, shk.1, ap.8. me vullnetin tone te lire e te plote, me daten 14.03.2001 krijuam shoqerine me pergjegjesi te kufizuar te emertuar "TOBACCO HOLLDINGS GROUP" SHPK.

Neni 2

Selia e shoqerise do te jete ne Tirane, rruga "Sami Frasheri", pall.20, shk.1, ap.8. Me vendim te asamblese se ortakeve mund te hapen agjensi, filiale, dege brenda teritorit te Shqiperise.

Neni 3

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise do te jete 10 vjet dhe do te filloi nga momenti i regjistrimit te saj ne regjistrin tregtar te gjykates Tirane, me perjashtim te rasteve kur mbaron sipas parashikimeve ne ligj ose kur vendos asambleja e ortakeve.



Neni 4

Shoqeria ka si objekt te veprimtarise se saj: Grumbullim, perpunim, prodhim duhan cigare, pije alkolike e freskuese. Import - eksport te lendes se pare dhe prodhimeve te duhanit, pijeve alkolike e freskuese. Tregtim me shumice dhe pakice te ketyre mallrave.

Neni 5

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 1.000.000 leke i formuar ne mase te plote nga kontributi i ortakeve si me poshte:

1. Lirim Fezollari derdhur 510.000 leke qe perbene 51 % te kapitalit themeltar te shoqerise.
2. Kosta Jankovski derdhur 250.000 leke qe perbene 25 % te kapitalit themeltar te shoqerise.
3. Zoran Jankovski derdhur 240.000 leke qe perbene 24 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Mbi bazen e kontributit te kapitalit do te ndahet edhe fitimi i realizuar gjate veprimtarise se shoqerise.

Kur njeri nga ortakët kerkon te largohet nga shoqeria, eshte i detyruar qe kapitalin e tij t'ua shesi ortakëve te tjere qe jane ne shoqeri. Ne rast se asnje nga ortakët nuk e blen kapitalin e ortakut qe largohet, ata duhet te bejne deklarate noteriale. Atehere ortakun qe largohet mund t'ja shesi kapitalin e tij nje personi jashte shoqerise, sipas vendimit qe do te marre asambleja e ortakëve.

Çmimi i shitjes se kapitalit te ortakut qe largohet do te vendoset me marreveshje te paleve qe hyjne ne kete mardhenie. Ne rastin e shitjes shlyerja e kapitalit do te behet sipas afateve qe do te caktoi asambleja e ortakëve.

Neni 6

Per nevoja te punes dhe te ushtrimit te aktivitetit te saj shoqeria mund te çele llogari ne çdo banke te njohur me ligj, qofte kjo private ose shtetore.



Levizjet e depozites ne banke do te behen me nenshkrimin e administratorit dhe ne mungese te tij, me autorizim te tij, ka te drejte te kryeje veprime njeri nga ortakët.

Neni 7

Per nevoja te punes kjo shoqeri mund te punesoje edhe punëtore e specialiste te ndryshem me kontrate te rregullt pune sipas ligjeve ne fuqi.

Neni 8

Administratore i shoqerise eshte Lirim Fezollari i cili eshte pergjegjës per shkelje ligjore, per shkelje te statutit ose per gabime e faje te kryera gjate administrimit.

Neni 9

Shoqeria do te rregullohet pervec ketij akti edhe me norma te percaktuara ne statutin e saj. Akti i themelimit u perpilua ne 4 kopje per tu administruar sipas ligjit.

ORTAKET

Lirim Fezollari

Kosta Jankovski

Zoran Jankovski



STATUTI
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
" TOBACCO HOLLDINGS GROUP " SH.P.K

STATUTI
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
" TOBACCO HOLLDDINGS GROUP " SH.P.K



FORMA, BAZA JURIDIKE, SELIA

Neni 1

Ne ortaket Lirim Fezollari, Kosta Jankovski, Zoran Jankovski, me daten 14.03.2001, kemi krijuar shoqerine me pergjegjesi te kufizuar te emertuar "**TOBACCO HOLLDDINGS GROUP**" sh.p.k

Neni 2

Shoqeria eshte formuar sipas legjislacionit shqiptar dhe si person juridik fillon me regjistrimin e saj ne regjistrin tregtar te gjykates se rrethit Tirane.

Neni 3

Shoqeria e ka seline ne Tirane, rruga "Sami Frasher", pall.20, shk.1, ap.8. Shoqeria mund te ndryshoj seline e saj me vendim te asamblese se ortakeve.

A handwritten signature in black ink, appearing to be "Lirim Fezollari".

A handwritten signature in black ink, appearing to be "Kosta Jankovski".

A handwritten signature in black ink, appearing to be "Zoran Jankovski".

Neni 4

Shoqeria zhvillon veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe me statutin e saj ne teritorin e Republikes se Shqiperise.

FUSHA E AUTORITETIT TE ORTAKEVE

Neni 5

Fusha e autoritetit te ortakut, perqindja e fitimeve ose e humbjeve, kompetencat qe gezon ne marrjen e vendimeve do te kene si kriter baze kapitalin e shoqerise.

Çdo ortak ka te drejte te marre pjese ne vendime dhe disponon nje numer votash te barabarte me pjeset e kapitalit themeltar.

LIBRI I SHOQERISE


Neni 6

Per te saktësuar veprimtarine e vet ekonomike si dhe mardheniet e punes, shoqeria do te kete librin e vet i cili do te quhet libri i shoqerise.

KONFIDENCIALITETI

Neni 7

Ortakët si dhe personat e tjere te pranuar ne shoqeri bien dakort qe te mos i ekspozojne asnje personi te jashtem informacionet qe disponon shoqeria kontratat qe do te lidhe si dhe planet ose qellimet qe ka per te ardhmen.





Neni 8

Te gjitha aktet dhe dokumentat qe nxirren nga shoqeria te destinuara per te tretet si letrat faturat lajmerimet dhe publikimet e ndryshme duhet te tregojne lexueshem emrin e shoqerise.

OBJEKTI

Neni 9

Shoqeria ka si objekt te veprimtarise se saj: Grumbullim, perpunim, prodhim duhan cigare, pije alkolike e freskuese. Import - eksport te lendes se pare dhe prodhimeve te duhanit, pijeve alkolike e freskuese. Tregtim me shumice dhe pakice te ketyre mallrave.

KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Neni 10

Shoqeria do te zhvilloj aktivitetin e saj 10 vjet, duke filluar nga data e regjistrimit te saj ne regjistrin tregtar te gjykates se rrethit Tirane, me perjashtim te rastit te mbarimit te afatit sipas kushteve te parashikuara ne ligj ose me vendim te asamblese se ortakeve.

KAPITALI THEMELTAR

Neni 11

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 1.000.000 leke. Shoqeria mund te zmadhoje kapitalin e saj ose ta zvogeloj deri ne kufirin e parashikuar nga ligji sipas vendimit te asamblese se ortakeve.

KONTRIBUTET

Neni 12

Kapitali themeltar i shoqerise eshte i formuar ne mase te plote nga kontributi i ortakeve si me poshte:

1. Lirim Fezollari ka derdhur 510.000 leke qe perbene 51 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

2. Kosta Jankovski ka derdhur 250.000 leke qe perbene 25 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

3. Zoran Jankovski ka derdhur 240.000 leke qe perbene 24 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Mbi bazen e kontributit te kapitalit do te ndahet edhe fitimi i realizuar gjate veprimtarise se shoqerise, mbi kete baze do te perballohen edhe humbjet.

Kur njeri nga ortakët kerkon te largohet nga shoqeria, eshte i detyruar qe kapitalin e tij t'ua shesi ortakeve te tjere qe jane ne shoqeri. Ne rast se asnje nga ortakët nuk e blen kapitalin e ortakut qe largohet, ata duhet te bejne deklarate noteriale. Atehere ortakut qe largohet mund t'ja shesi kapitalin e tij nje personi jashte shoqerise, sipas vendimit qe do te marre asambleja e ortakeve.

Çmimi i shitjes se kapitalit te ortakut qe largohet do te vendoset me marreveshje te paleve qe hyjne ne kete mardhenie. Ne rastin e shitjes shlyerja e kapitalit do te behet sipas afateve qe do te caktoi asambleja e ortakeve.

LENIA DHE TRANSFERIMI I PJESEVE TE KAPITALIT

Neni 13

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme tek personat e trete ne qofte se vendos per kete asambleja e ortakeve. Gjitheashtu ato jane lirisht te transferueshme ne rast ndarje pasurore mes bashkeshorteve si dhe ne rruge trashgimie.

Transferimet e pjeseve te kapitalit themeltar duhet te vertetohen me nje akt noterial.





STRUKTURA JURIDIKE DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Neni 14

Shoqeria mund te hape filial, dege, agjensi ne te gjitha ato vende ku do te shikoje interes ne permbushjen e qellimit te saj ne te gjithe teritorin e Republikes se Shqiperise.

Neni 15

Organet drejtuese te shoqerise jane si me poshte:

- 1.Asambleja e ortakeve,
- 2.Administratori,

ADMINISTRATORI


Neni 16

Administratore i shoqerise eshte Lirim Fezollari i cili eshte pergjegjes per shkelje ligjore, per shkelje te statutit ose per gabime e faje te kryera gjate administrimit.

LIBRAT E SHOQERISE, BILANCI, SHPERNDARJA DHE LIKUJDIMI

Neni 17

Shoqeria eshte e detyruar te mbaje dokumentacionin kontabel. Librin e shoqerise ne te cilin shenohen emri i plote i shoqerise, ortaket, kapitali themeltar si dhe vendimet qe merr asambleja e ortakeve.



Neni 21

Asambleja e ortakeve ka te drejte te emeruje ekonomiste dhe avokate si dhe tu jap te drejte personave te trete qe te veprojne ne emer e per llogari te saj me autorizim apo me prokure, ne perputhje te plote me ligjin shqiptar.

Neni 22

Shperndarja e shoqerise mund te vije per çdo arsye. Per kete asambleja e ortakeve vendos dhe cakton menyren e likujdimit te saj. Caktohet nje ose disa likujdatore. Keta bejne kujdes qe shoqeria te likujdoje me pare detyrimet qe ajo u ka personave fizik e juridik.

Neni 23

Shoqeria ka vulen e saj me permbajtje **"TOBACCO HOLLIDINGS GROUP"** SH.P.K. TIRANE Albania.


DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 24

Persa nuk eshte shkruar ne kete statut gjate veprimtarise se shoqerise do te behen plotesime me vendim te asamblese se ortakeve sipas ligjeve perkatese shqiptare per shoqerite tregtare.

Neni 25

Te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin gjate ekzistences se shoqerise ose gjate periudhes se likujdimit do ti paraqiten per zgjidhje gjykates kompetente.



Neni 26

Ky statut eshte hartuar ne 4 kopje per tu administruar sipas ligjit.

Lirim Fezollari

ORTAKET

Kosta Jankovski

Zoran Jankovski.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA POGRADEC

Nr. 815rep.

Nr. 106kol.

VERTETIM

Ne Pogradec sot me daten 19. Mrs 2001 (dymijenje), para meje noterit Thoma Bici, u paraqiten personalisht z. Lirim FEZOLLARI, me pasaporte Nr.0477924, z. Kosta JANKOVSKI me pasaporte maqedonase nr. 1512384dhe z. Zoran JANKOVSKI, me pasaporte maqedonase Nr.1032225. Ata jane madhore, me zotesi te plote per te vepruar, te cilet deklarojne se sa me siper eshte Statuti i Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "TOBACCO HOLLDINGS GROUP", i redaktuar jashte kesaj zyre sipas vullnetit te tyre te lire e te plote dhe e nenshkruan para meje, ndersa une noteri vertetoj firmat sipas ligjit.



NOTERI

Thoma Bici